



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 24/1 prot.

Tiranë, më 18.1.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion të datës 8.1.2024

Z. A D , GAZETAR
Të dhëna kontakti:

I nderuar z. D ,

Në përgjigje të kërkesës juaj për informacion, dërguar me e-mail në datën 5.1.2024, tek koordinatori për të drejtën e informimit dhe protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 24 prot., datë 8.1.2024, ju informojmë se:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka publikuar në faqen e tij zyrtare në datë 11.9.2019, vendimin e arsyetuar me shkrim të trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit z. K B , vendim i cili nuk është ankimuar në shkallën e dytë të vetingut, për rrjedhojë vendimi ka marrë formë të prerë në datën 1.10.2019. Vendimin e formës së prerë nr. 191, datë 26.7.2019, e gjeni përmes këtij linku: https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/09/Vendim-K _ -B .pdf.

Nga faqja 19 e vendimit të arsyetuar me shkrim, deri në faqën 21, lutem gjeni informacion në lidhje me kontrollin e figurës, të kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar për këtë subjekt.

Magjistratët të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit, i nënshtrohen kontrolleve dhe vlerësimeve periodike nga organet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, në përputhje me detyrimet që burojnë nga ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Edmond Vercani

